



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:299887
Datë: 24.05.2024
Numri i dokumentit: 05733232

Ac.nr.1262/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Naime Ahmeti, kryetare e kolegjit, Adnan Konushevci dhe Ylber Shurdhiqi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit V.B. nga Ferizaj, të cilin me autorizim e përfaqëson L.M. avokat nga Ferizaj, kundër të paditurit Sh.H. nga Ferizaji, të cilin me autorizim e përfaqëson V.A. avokat nga Ferizaji, në çështjen juridike kompensim i dëmit material dhe jo material, duke vendosur përkitazi me ankesën e të autorizuarit të paditurit, e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1641/2019 të datës 06.01.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më 16.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. RFUZOHET pjesërisht e pathemeltë ankesa e të paditurit Sh.H. nga Ferizaji, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1641/2019 të datës 06.01.2021, në pikën I (një) dhe II (dy) lidhur me kompensimin e dëmit jo material në emër të dhimbjeve fizike, frikës primare dhe për shëmtim trupor në shkallë të lehtë si dhe për dëmin material në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj dhe ushqimit të përforcuar, dhe pjesërisht pika IV (katër) e dispozitivit, lidhur me kompensimin e shpenzimeve të procedurës, VËRTETOHET.

II. APROVOHET pjesërisht e themeltë ankesa e të autorizuarit të paditurit Sh.H. nga Ferizaji, NDRYSHOHET pjesërisht pika II (dy) e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1641/2019 të datës 06.01.2021, në emër të dëmit material gjykohet si në vijim: REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit V.B. nga Ferizaji, ndaj të paditurit Sh.H. nga Ferizaji, që për kompensimin e dëmit material në emër të rehabilitimit fizioterapeutik t'ia paguaj shumën prej 150.00 €, si e pabazuar.

III. Pika III (tre) e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, C.nr.33/2017 i datës 16.02.2021, mbetet e pashqyrtuar (paprekur).

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar C.nr.1641/19 të datës 06.01.2020, në pikën një të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit V.B., nga Ferizaj, si e bazuar. Në pikën II të dispozitivit është detyruar i padituri Sh.H., që paditësit në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material (lëndime trupore), të shkaktuara nga i padituri me dt.16.07.2019 t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 4,050€ dhe atë: në emër të dëmit material dhe jo material, për dhimbje fizike shumën prej 1,500, në emër të emër të frikës primare 1,000 €, në emër të shëmtimit trupor shkalla e lehtë shumën prej 1,000€, në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj 14 dite, shumen prej 150€, në emër të ushqimit të përforcuar 21 dite 250 €, dhe në emër të rehabilitimit fizeoterapi 10 dite 150€. Në pikën III të dispozitivit është refuzuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë mbi shumat e aprovuara si në pikën (II), të dispozitivit në lartësi prej 4,000 € dhe atë; në emër të dëmit material dhe jo material, për dhimbje trupore –fizike shumën prej 1,500 euro, për frikë të pësuar shumën prej 1.000 euro, dhe në emër të shëmtimit trupor shkalla e lehtë shumën prej 1,500€. Në pikën IV të dispozitivit është detyruar i padituri që shumën e përgjithshme prej 4,050 € dhe në emër të shpenzimeve të procedurës shumën prej 777 euro, t'ia paguaj paditësit në afat prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit.

Kundër këtij aktgjykimi i autorizuar i të paditurit në afat ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën si të bazuar, aktgjykimin e atakuar ta anuloj dhe lëndën t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa është pjesërisht e themeltë

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, përmes të autorizuarit të tij, pranë gjykatës së shkallës së parë ka parashtruar padi me datë 30.12.2019, kundër të paditurit Sh.H. nga Ferizaji, për kompensim dëmi. Përfaqësuesi i paditësi ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia e precizuar në seancën e shqyrtimit kryesor të dt. 08.12.2020, ashtu që të detyrohet i padituri që në emër të lëndimeve të shkaktuara paditësit si rezultat i veprës penale, për dhimbje fizike për të gjitha format t'ia paguaj shumën prej 2,000.00 €, në emër të frikës primare shumën prej 1,000.00 €, në emër të ndihma e personit të huaj shumën prej 150 €, ushqimit të përforcuar shumën prej 250 €, rehabilitim fizioterapeutik shumën prej 150 €, për shpenzime të shërimit shumën prej 19.50 € dhe shumën prej 44.50 €, me kamatë ligjore si dhe shpenzimet e procedurës sipas parashtrësës së precizuar me datë 02.11.2020.

Duke vepruar sipas padisë së paditësit, gjykata e shkallës së parë ka zhvilluar procedurën gjyqësore dhe ka vendosur për aprovimin e kërkesëpadisë, pas administrimit dhe shqyrtimit të provave: Raportet Mjekësor në emër të paditësit, kuponat fiskal, Aktgjykim P.nr.958/19 dt.10.12.2019, dhe ekspertiza mjekësore dt.23.10.2020. Gjukata e shkallës së parë, bazën e kërkesëpadisë e ka vërtetuar me aktgjykimin penal P.nr.958/19 dt.10.12.2019, ndërsa në bazë të ekspertizës mjekësore ka vendosur lidhur me lartësinë e kompensimit të dëmeve materiale dhe jo materiale duke u bazuar në dispozitat e nenit 136, 173.1, 179, 183 dhe 382 të LMD-së, ndërsa lidhur me shpenzimet e procedurës ka vendosur konform dispozitës së nenit 452.1, 453 dhe 449 të LPK-së.

Gjukata e Apelit, nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pikat (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjukata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, por gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale kur ka gjykuar lartësinë e kërkesëpadisë së aprovuar në emër të dëmit material për rehabilitim fizioterapeutik, për çka u deshtë që aktgjykimi i atakuar në fjalë të ndryshohet dhe të vendoset si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjukata e Apelit ka vendosur sikurse në pikën I të këtij aktgjykimi, duke gjetur se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur në lidhje me pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësit, duke marrë parasysh natyrën e lëndimeve (të lehta trupore), si dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve dhe frikës, është vendosur që të vërtetohen shumat e kompensimit në emër të dëmit jo material si kompensim i drejtë dhe real edhe sa i përket dëmit jo material shëmtimit trupor në shkallë të lehtë, duke u mbështetur edhe në thëniet e ekspertizës mjekësore, ku janë trajtuar këto forma të dëmit. Gjatë vendosjes lidhur me to, gjykata e shkallës së parë, është mbështetur siç duhet në nenin 323 të LPK-së, ndërsa që kërkesëpadia e paditësit sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së dytë gjënë mbështetje edhe në dispozitën e nenit 136 paragrafi 1 të LMD-së, (Ligji Nr. 04/L-077) i cili decidivisht thotë se: *‘Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensoj, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij’*. Duke qenë se në rastin konkret me aktgjykimin penal P.nr. 958/19 dt.10.12.2019, të marrë nga Gjukata Themelore në Ferizaj, është vërtetuar fajësia e të paditurit, atëherë ekziston përgjegjësia në bazë të fajësisë siç përcaktohet me dispozitën e nenit 140 të ligjit të sipërcituar se: *‘Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje apo nga pakujdesia’*. Nga interpretimi i tillë i dispozitave ligjore të cekura më lartë, rezulton se i padituri është përgjegjës për kompensimin e dëmit të shkaktuar me rastin e lëndimit të paditësit me datën 16.07.2019, në rrugën “...” në Ferizaj, me dashje dhe me mjet të rrezikshëm i padituri i ka shkaktuar kështu lëndim të lehtë trupor, e që në të njëjtën kohë shuma e aprovuar nga gjykata e shkallës së parë, është shumë reale, për aq sa është e mundur, për rivendosjen e gjendjes e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi, duke u kujdesur për rendësin e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me të mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror, për kompensimin e dëmit, siç është e përcaktuar me dispozitën e nenit 183 par.2 të LMD-së. Në

kuptim të kësaj, konstatohet se gjykata e shkallës së parë ka vepruar konform një dispozite të tillë.

Në mënyrë të drejtë, gjykata e shkallës së parë ka vendosur edhe mbi shumën në emër të dëmit material, për kujdes dhe ndihmës së huaj meqë, siç theksohet edhe në mendimin e ekspertëve mjekësor, paditësi ka pasur nevojë për ndihmë të personit të tretë për 14 ditë dhe për ushqim të përforëuar për 21 ditë. Edhe pse një formë e tillë e dëmit është më e vështirë për t'u vërtetuar me prova konkrete, praktika e Gjykatave të Kosovës e njeh kompensimin e dëmit të tillë, e meqenëse është konstatuar nevoja për ndihmën e personit të tretë dhe ushqimin e përforëuar.

Më tutje, gjykata e shkallës së dytë e ka vërtetuar edhe vendimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me kumatën e gjykuar, pasi që e njëjta është në përputhje me dispozitën e nenit 382 par.2 të LMD-së. Gjithashtu është vërtetuar edhe vendimi mbi shpenzimet procedurale, duke qenë se gjykata e shkallës së parë, me të drejtë është bazuar në nenin 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit i ka vlerësuar thëniet ankimore të autorizuarit të paditurit lidhur me atë se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika o) të LPK-së, se me aktgjykimin e atakuar është tejkalluar kërkesëpadia e paditësit si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, me rastin e aprovimit të kërkesëpadiës së paditësit lidhur me kompensimin e dëmit jo material në emër të shëmtimit trupor në shkallë të lehtë, duke e detyruar të paditurin që t'ia kompensoj shumën prej 1,000.00 €, se përfaqësuesi i paditësit në shqyrtimin kryesor të çështjes të datës 08.12.2020 ka bërë precizimin e kërkesëpadiës duke mos e precizuar këtë formë të dëmit, dhe ka vlerësuar se është pretendim ankimor i pabazuar sepse me parashtresën e datës 02.11.2020 përfaqësuesi i paditësit e ka precizuar kërkesëpadinë, kështu që në emër të shëmtimit trupor shkalla e lehtë është kërkuar shuma prej 2,500.00 €, gjykata ka aprovuar shumën prej 1,000.00€, duke e refuzuar përtej asaj të gjykuar në shumë prej 1,500.00 €, si në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, ndërsa në shqyrtimin kryesor të çështjes përfaqësuesi i paditësit i ka precizuar shumën në emër të dhimbjeve fizike dhe frikës primare, për të tjerat ka mbetur si në parashtresën e precizuar, andaj në rastin konkret nuk kemi tejkallim të kërkesëpadiës, veçse gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë për këtë kategori të dëmit jo material me aplikim të drejtë të dispozitave të materiale të përshkruara si më lartë.

Gjykata e Apelit, vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e precizuar të paditësit në emër të dëmit material për rehabilitim fizioterapeutik në shumë prej 150 €, pasi që referuar shkresave të lëndës rezultoi se pala paditëse nuk i ka ofruar gjykatës së shkallës së parë prova përkatëse materiale (fatura) të cilat dëshmojnë lartësinë e këtyre shpenzimeve.

Andaj, kolegji vlerëson se në këtë rast, janë përmbushur kërkesat ligjore nga neni 201 i LPK-së, dhe nenet 182 dhe 183 të LMD-së, që të ndryshohet aktgjykimin ankimor dhe të refuzohet shuma e shpërblimit të dëmit material në emër të rehabilitimit fizioterapeutik, si në pikën II të dispozitivit të gjykatës së shkallës së dytë.

Pika III e dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar nuk është shqyrtuar nga ana e Gjykatës së Apelit, pasi që kjo pjesë të dispozitivit të aktgjykimit nuk është atakuar përmes ankesës nga i autorizuari i paditësit, ndërsa i padituri nuk ka pasur interes për ta atakuar me ankesë.

Gjykata e Apelit, me rastin e vendosjes, shqyrtoi edhe të gjitha pretendimet tjera ankimore të palës së paditur, por të njëjtat nuk patën ndikim relevant në vendosjen ndryshe në këtë çështje juridike, përveç asaj pjese të ndryshuar.

Nga të gjitha arsyet e cekura në arsyetim të këtij aktgjykimi të shkallës së dytë, Gjykatës së Apelit i rezulton se gjykata e shkallës së parë, në pjesët e vërtetuara të aktgjykimit ankimor, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, përveç pjesës së ndryshuar. Andaj në mbështetje të dispozitave nga nenet 194 dhe 195 paragrafi 1 pikat d) dhe e), lidhur me nenin 200 të LPK-së, Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.1262/2021, më datë 16.05.2024

Kryetare e kolegjit
Naime Ahmeti, d.v.